



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
OPSTINA SUVA REKA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË



REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKË	
16-06-2026	
IN-	Q-RECEIVED
Org	Org
01	016 27657

Datë: 16.06.2026

Në bazë të Vendimit Nr. 01-Nr-016-2991, datë 26.03.2026 të Kuvendit Komunal dhe në bazë të Procesverbalit Nr. 03/2026 të Komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të datës 26.03.2026, komisioni përkatës shpall:

KONKURRIM TË HAPUR-RI-SHPALLJE

Nr. 01/2026

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri në 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës komunale:

Banesa e cila gjendet në rrugën "Brigada 123" në Suharekë, objekti O-72116046-56-2-13-0, hyrja H-2, kati përdhesë (NK), sipas sistemit të unifikuar të adresave, me sipërfaqe të përgjithshme prej $S = 58.97 \text{ m}^2$, pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Deklarata e bashkësisë familjare, e lëshuar nga sektori i gjendjes civile.

Kriteret e vlerësimit:

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara – 10%
- Përparësi kanë familjet e dëshmorëve – 60%
- Dëshmi që ofertuesi është anëtar i familjes së dëshmorit – 10%
- Çmimi fillestar për m^2 : 1 € / muaj – 20%

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve nënkupton diskualifikim.
- Aplikuesi ka të drejtë të tërhiqet nga aplikimi jo më vonë se 3 (tri) ditë nga hapja e ofertave.
- Familjet të cilat kanë përfituar parcelë, banesë, shtëpi apo përfitime të ngjashme për sigurim të banimit nga Komuna nuk kanë të drejtë konkurrimi.
- Aplikuesi mund të jetë përfitues vetëm i një njësie banesore.
- Aplikuesi duhet të specifikojë për cilën njësi banesore aplikon, duke përfshirë numrin, katin dhe sipërfaqen në m^2 .

Sqarim:

Banesa e lartcekura kanë nevojë për renovim.

Afati për tërheqjen e formularëve të ofertave është deri më datë 01.07.2026, në Zyrën e Gjendjes Civile nr. 1, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave është deri më datë 01.07.2026, deri në ora 13:30, në Zyrën Pritëse nr. 1, Komuna Suharekë.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf dhe të protokoluara në Zyrën Pritëse nr. 1.

Hapja e ofertave bëhet më 01.07.2026 në ora 14:30, në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës i emëruar nga Kuvendi Komunal i Suharekës, ndërsa përfituesin e vendos Kuvendi Komunal konform Ligjit Nr. 06/L-092.

Për informata shtesë:

Tel: 049/563-420

Armend Krasniqi

